



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Klinë, 22.6.2020, Prot. 04-111-1353 0/20
Në bazë të nenit 5, pika b, të Ligjit nr.03/L-068 për Arsim në Komunitet të Republikës së Kosovës dhe në bazë të Ligjit për Parashkollor nr.02/L-52 dhe kalendarit të MASHT-it për përfundimin e vitit shkollor 2019-2020 në rrethana të pandemisë

Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me
Institucionin parashkollor, "XHEVË LLADROVCI" Klinë, shpall:

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE NË KËTË INSTITUCION PËR VITIN KALENDARIK
2020/2021

NUMRI I FËMIJËVE QË DO TË PRANOHEN

Nr	Grup-mosha	Numri i fëmijëve
1	1-3 vjeç	18 fëmijë
2	3-4 vjeç	15 fëmijë
4	4-5 vjeç grupi I	18 fëmijë
5	4-5 vjeç grupi II	18 fëmijë
6	5-6 vjeç	15 fëmijë
	Gjithsej	84 fëmijë

Konkursi është i hapur nga data, 22.06.2020 deri më datën 04.07.2020.

Aplikimi bëhet në Institucionin Parashkollor çdo ditë pune nga ora 9⁰⁰ deri në ora 14⁰⁰.

Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:

- Aplikacioni i plotësuar
- Ekstrakti i lindjes së fëmijës
- Dëshmia nga mjeku për gjendjen shëndetësore të fëmijës
- Dëshmia për vaksionimin e fëmijës
- Dëshmia që jeni banor të Klinës
- Vërtetimi i kontributit nga trusti pensional, për tre muajt e fundit
- Kontrata e punës (nëse dy prindërit i punojnë)
- Dokumentet tjera të vlefshme të lëshuara nga institucionet relevante për të dëshmuar kategorit tjera.

Dokumentet e pa kompletuara si dhe pas mbylljes së konkursit nuk pranojnë.

Shpallja e rezultateve bëhet me 29 gusht, në I.Parashkollor, „Xhevë Lladrovci”